4/
/01.2023

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA PRRENJAS
KESHILLI I BASHKISE PRRENJAS

Nr. 71 prot.

Data 09.01.2023

# VENDIM

Nr. 11 ,Date 26.12 2022

## PER
## MIRATIMIN E PAKETËS FISKALE TË BASHKISË PRRENJAS PËR VITIN 2023 DHE PLANIN E TE ARDHURAVE 2023

Paketa fiskale e Bashkisë Prrenjas për vitin 2023, paraqet propozimet për sistemin e ri të taksave dhe tarifave vendore që do të zbatohen për vitin buxhetor 2023, duke përcaktuar nivelin e taksave dhe tarifave vendore, lehtësirat fiskale, strukturat e vjeljes së tyre dhe vendosjen e penaliteteve ndaj kundravajtësve në të gjithë shtrirjen administrative të Bashkisë.

Në mënyrë të përmbledhur kjo paketë fiskale synon:

a) Përditësimin dhe aplikimin e kornizës ligjore të ndryshuar;
b) Përditësimin e procedurave, afateve, aktorëve, veprimeve, përgjegjësive për vjeljen e çdotakse dhe tarife, pjesë e kësaj pakete fiskale.
c) Përmirësimin e sistemit fiskal efiçent dhe transparent;
d) Përcaktimine qartë në seksione të taksave dhe tarifave.
e) Është synuar në një

- Taksim të drejtë;
- Tarifim tëmbështetur në kosto shërbimi;
- Klasifikim i biznesit sipas qarkullimit vjetor, llojit të aktivitetit, vendodhjes, etj.

h) Aplikimi i incentivave, lehtësirave fiskale, përjashtimeve për grupe të caktuarataksapaguesish në nevojë, për aq sa lejon dhe ligji.

## Baza Ligjore :

Ligji nr 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, përbën ligjin bazë për reformat e decentralizimit të pushtetit vendor dhe përcakton rregullat për ushtrimin e të drejtave dhe detyrave të njësive të qeverisjes vendore në drejtim të krijimit të taksave vendore, mbledhjen dhe administrimin e tyre.

Bazuar në Ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 *"Për vetqeverisjen vendore"*, Ligji nr 9632, date 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, Ligjin 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" dhe Ligjin nr.9975, datë 28.7.2008 "Për taksat kombëtare", i ndryshuar, në të ardhurat vendore përfshihen kryesisht:

- ✓ Tatim i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël;
- ✓ Taksa mbi pasurinë e paluajtshme
- ✓ Taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja;
- ✓ Taksa e fjetjes në hotel;
- ✓ Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme;
- ✓ Taksa e tabelës/reklamat;
- ✓ Taksa e mjeteve të përdorura të transportit;
- ✓ Taksa e rentës minerare;
- ✓ Të ardhura nga tatimi mbi të ardhurat personale;
- ✓ Tarifa për shërbime;

Më poshtë në mënyrë të përmbledhur jepet legjislacioni fiskal vendor, i cili është konsultuar për tëhartuar këtë paketë fiskale.

- ✓ Ligji nr 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", ndryshuar me Ligjin nr. 9745 datë 28.05.07; ndryshuar me Ligjin nr. 9764, datë 09.07.2007; ndryshuar me Ligjin nr. 9931, datë 09.06.2008; ndryshuar me Ligjin nr. 10 073, datë 9.2.2009; ndryshuar me Ligjin nr. 10117 dt. 23.4.2009; ndryshuar me Ligjin nr. 10146 dt.28.9.2009; ndryshuar me Ligjin Nr. 10354 , datë 18.11.2010; ndryshuar me Ligjin nr. 10457, datë 21.07.2011; ndryshuar me Ligjin nr. 106/2013, datë 28.3.2013; ndryshuar me Ligjin nr. 181/2013, datë 28.12.2013; ndryshuar me Ligjin nr. 85/2014, datë 17.07.2014; ndryshuar me Ligjin nr. 181/2013, dt. 28.12.2013; ndryshuar me Ligjin nr. 142/2015, datë 17.12.2015;ndryshuar me Ligjin nr.106/2017; ndryshuar me Ligjin Nr. 41/2018;Aktin Normativ Nr. 3, datë 2.10.2019;
- ✓ Ligji nr.139/2015, datë 17.12.2015 *"Për vetqeverisjen vendore"' i ndryshuar*
- ✓ Ligji nr. 8438 datë 28.12.1998, *"Për tatimin mbi të ardhurat"*, i ndryshuar;
- ✓ Ligji nr.9723, datë 3.5.2007 *"Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", i ndryshuar;*
- ✓ Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 *"Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë"*, i
- ✓ ndryshuar;

- ✓ Ligji nr.10081, datë 23.2.2009, *"Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e*
- ✓ *Shqipërisë"* i ndryshuar";
- ✓ Ligji nr. 10304, datë 15.7.2010, *"Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë";*
- ✓ Ligji nr.9975, datë 28.7.2008 *"Për taksat kombëtare"*, i ndryshuar;
- ✓ Ligji nr. 93/2015 *"Për turizmin", i* ndryshuar;
- ✓ Ligji Nr. 9482, datë 03.04.2006 *"Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje",* i ndryshuar;
- ✓ Ligji Nr 107/*2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i* ndryshuar;
- ✓ Ligji Nr.10465, datë 29.9.2011 *"Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", i*
- ✓ ndryshuar;
- ✓ Ligji Nr.8450, datë 24.2.1999 *"Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit*
- ✓ *dhe nënprodukteve të tyre",*
- ✓ Ligji. Nr. 9385, datë 4.5.2005 *"Për pyjet dhe shërbimin pyjor", i* ndryshuar;
- ✓ Ligji Nr. 9693, datë 19.3.2007 *"Për fondin kullosor",* i ndryshuar;
- ✓ Ligji Nr. 10279, datë 20.05.2010 *"Për kundravajtjet administrative", i* ndryshuar;
- ✓ Ligji Nr.8744, datë 22.2.2001 *"Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit nënjësitë e qeverisjes vendore",* i ndryshuar;
- ✓ Ligji Nr.10296, datë 08/07/2010, *"Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i* ndryshuar;
- ✓ Ligji nr. 10463, datë 22.9.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", i ndryshuar;
- ✓ Ligji nr. 152/2015, datë 21.12.2015, "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin";
- ✓ Ligji. nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore";
- ✓ Ligji nr. 22/2018 "Për strehimin social";

## Vendime dhe udhëzime:

- ✓ Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 505, datë 1.8.2007 *"Për miratimin e Statutit të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit*";
- ✓ Vendimi i Këshillit të Ministrave, nr. 783, datë 10.11.2011, *"Për procedurat e ndarjes së të ardhurave të taksës vjetore të mjeteve të përdorura me njësitë e qeverisjes vendore*";
- ✓ VKM Nr.7, datë 4.01.2012, *"Për përcaktimin e procedurave dhe të dokumentacionit të nevojshëm për arkëtimin e taksës së rentës minerare"*, i ndryshuar.
- ✓ VKM Nr. 970, dt 02.12.2015 *"Për përcaktimin e proçedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj"I ndryshuar me VKM nr.344 date19.04.2017*;
- ✓ VKM Nr. 396, datë 21.6.2006 *"Për kriteret e transferimit dhe të përdorimit të pyjeve nga njësitë e qeverisjes vendore";*
- ✓ VKM nr. 391 datë 21.06.2006 *"Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave";*
- ✓ VKM 632 datë 11.06.2009 "*Për tarifat në sektorin e Kullotave",*

- ✓ VKM nr.1064 datë 22.12.2010 *"Për disa ndryshime në VKM nr. 391 datë 21.06.2006 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave"*;
- ✓ VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"*, i *ndryshuar;* VKM nr. 54, datë 05.02.2014 *"Për përcaktimin e kritereve, dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore"*, i ndryshuar.
- ✓ Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 992, datë 9.12.2015 *"Për disa ndryshime në vendimin nr.54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kritereve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteoze apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore"*, të ndryshuar;
- ✓ VKM Nr.469, datë 3.6.2015, *"Për përcaktimin e vlerës minimale të çmimit të referencave të qirave të ndërtesave për qëllime tatimore"*;
- ✓ VKM Nr. 575, datë 24.6.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte";
- ✓ VKM Nr. 285, date 27.6.2002 "Për tarifat e shërbimeve që kryen policia e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit ndaj shtetasve dhe personave, juridikë e fizikë, vendas e të huaj";
- ✓ VKM Nr.1108, date 30.12.2015 "Për transferimin, nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit rural dhe Administrimit të ujërave te Bashkitë, të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme e të paluajtshme të Bordeve Rajonale të Kullimit";
- ✓ VKM nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", neni 27 pika 4;
- ✓ VKM nr. 132, datë 7.3.2018 për Metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme "ndërtesa", e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e formacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kritereve dhe rregullave për vlerësimin alternative të detyrimit të taksës.
- ✓ Udhëzimi nr. 1, datë 16.06.2011 "Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të KM "Për mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, pika 4.
- ✓ Udhëzim i Ministrit të Financave Nr.1, datë 12.1.2007 *"Për përcaktimin e veprimtarive që trajtohen si veprimtari, tregtare apo shërbimi, ambulante si dhe procedurat e regjistrimit të tyre në organin tatimor"*;
- ✓ Udhëzim i Ministrit të Financave*Nr.32, datë 31.12.2013*, *"Për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël"*, i ndryshuar.
- ✓ Udhëzim i Ministrit të Financave Nr.26, datë 4.09.2008, *"Për taksat kombëtare"*, I ndryshuar.
- ✓ Udhëzim i Përbashkët (Ministri i Financave dhe Ministri i Drejtësisë) Nr. 655/1, datë
- ✓ 06.02.2007 *"Për Përcaktimin e Uniformitetit të Standardeve Proceduriale dhe të Raportimit të Sistemit të taksës Vendore "*;
- ✓ Udhëzim i Ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes nr. 6756, date 3.9.2015 *"Për zbatimin e vendimin të Këshillit të Ministrave nr. 54, datë 5.2.2014 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore"*, i ndryshuar;
- ✓ Udhëzim nr.30, datë 27.12.2011, *"Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik", I ndryshuar;*

- ✓ Udhëzuesi i Ministrit për Çeshtjet Vendore nr 541/1, date 31.12.2015 *"Udhëzues për zbatimin e VKM nr.1108 dat.30.12.2015 "Për transferimin nga MBZHRAU tek bashkitë, të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme dhe të*
- ✓ *paluajtshme";*
- ✓ Urdhëri i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, nr 189, datë 04.05.2018 *"Për miratimin e çertifikatës shëndetësore veterinare për mishin e kafshëve të llojit gjedh, të imta, derra të therura në thertore"*
- ✓ Urdhëri i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, nr 190, datë 04.05.2018 *"Për miratimin e çertifikatës shëndetësore veterinare që shoqëron lëvizjen dhe transportin e ngarkesave me lëkurë dhe produkte me origjinë shtazore jo për konsum njerëzor".*
- ✓ *Vendimimi nr.607, date 25.07.2020,"Per tarifat per llojet e sherbimeve qe ofrohen nga sherbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimi".*

Në mbështetje të ligjeve të cituara me lart, Paketa fiskale e Bashkisë Prrenjas për vitin 2023 ka reflektuar ndryshimet ligjore, por dhe përshtatjen e treguesve të taksave e tarifave vendore, ndryshimeve administrative, shtrirjes gjeografike dhe nivelit ekonomik të njesive administrative përbërëse të Bashkisë.
Të gjitha këto ndryshime do të shërbejne si instrument për rritjen e eficencës administrative, profesionale dhe teknike të qeverisjes vendore, nëpermjet rritjes së të ardhurave për t'i dhënë shërbime më të mira për qytetarët.
Paketa fiskale e Bashkisë Prrenjas për vitin 2023 është e përbërë nga taksa e tarifa vendore të distinuara për juridiksionin e kësaj Bashkie.
Nivelet e taksave vendor jane kryesisht të miratuara ne ligj nga Kuvendi i Shqiperise,por per nevoja te qeverisjes vendor,Keshilli Bashkiak ka të drejtë të miratojë dhe taksa të përkohshme apo tarifa , që i sherbejne një objektivi të caktuar për përmirësimin e situatave në infrastrukturën e teritorit brenda juridiksionit të Bashkisë.
Për kuptimin me të saktë të materialit të referuar më poshtë, është e nevojshme dhe prezantimi i termave të saj si :

1. "**Baza e taksës**" është vlera mbi të cilën zbatohet taksa vendore sipas llojit të taksës ajo mund të kuptojë pasurinë, të ardhurat, çmimin ose vlerën e transaksionit.
2. "**Niveli tregues i taksës**" janë nivelet referuese të taksave vendore të parashikuara në ligj, mbi të cilat ka të drejtë të vendos Këshilli Bashkia në çdo vit buxhetor.
3. "**Taksë vendore**" është një pagesë e detyrueshme dhe e pakthyeshme në buxhetin e Bashkisë, e vendosur me ligj e miratura në paketën fiskale, dhe që paguhet nga çdo person që ushtron një të drejtë apo përfiton një shërbim publik në territorin e njësisë së vetëqeverisjes vendore.
4. "**Tarifë vendore**" është një pagesë që një individ, person fizik apo juridik bën në shkëmbim të një shërbimi specifik të marrë, të mirë publike specifike të përdorur apo të drejte të dhënë nga Bashkia.
5. "**Taksë ose tatim i ndarë**" është një taksë kombëtare ose tatim i përcaktuar sipas ligjit për procedurat tatimore ose ligjeve të veçanta tatimore, të ardhurat respektive prej të cilave

ndahen, plotësisht ose pjesërisht, me njësitë e vetëqeverisjes vendore, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

6. **"Të ardhura nga burimet e veta"** janë të gjitha të ardhurat që krijohen dhe administrohen në nivel vendor, nën autoritetin e Bashkisë, sipas legjislacionit në fuqi.
7. **"Agjent i taksave dhe tarifave"** është personi juridik/institucioni, i cili, është përgjegjës për arkëtimin dhe transferimin në llogarinë e Bashkisë të të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore.

Këshillit te Bashkisë Prrenjas ju parqitet për

MIRATIM :

Për të gjithë kategoritë e tatimpaguesve dhe përfituesve të shërbimeve publike, të ofruara në territorin brenda juridiksionit të Bashkisë Prrenjas:

1. nivelin e taksave dhe tarifave vendore ,
2. afatet e pagesës,
3. përjashtimet e lehtesirat fiskale për çdo kategori përfituese ,
4. strukturat përgjegjëse për vjeljen e tyre ,
5. të drejten e ankimimit për çdo vlërsim ,
6. arsyen e vendosjes së penalitetetеve/ gjobave për kundravajtjen e shkaktuara nga tatimpaguesit ,
7. nivelin e tyre për çdo kundravajtje si dhe
8. strukturat e ngarkuara për vendosjen e vjeljen e tyre.

## A. TAKSAT VENDORE

Ne zerin " Taksa vendore ", konform ligjit nr.9632, date 30.10.2006 "Per Sistetimin e Taksave Vendore", i ndryshuar, perfshihen llojet e tyre si me poshte :

1. Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin (Taksa Taksa e Biznesit te vogel )
2. Taksa mbi pasurine e paluajtshme
   a.Taksa mbi ndertesen,
   b.Taksa mbi token bujqesore,
   c.Taksa mbi truallin,
3. Taksa mbi kalimin e te drejtes se pronesise per Pasurite e Paluajtshme.
4. Taksa e ndertitmit ne infrastrukture per Ndertimet e Reja
5. Taksa e tabeles
6. Taksa e regjistrimit te pervitshem te automjeteve te transportit rrugor
7. Taksa e fjetjes ne hotel
8. Taksa te perkohshme

## A.1. TATIMI I THJESHTUAR MBI FITIMIN PER BIZNESIN E VOGEL

Shkalla tatimore e aplikueshme mbi fitimin e tatueshëm për tatimpaguesit që i është nënshtruar tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, me qarkullim vjetor nga 0 (zero) deri në 5

milionë lekë ishte 0% dhe nga 5 milionë lekë në 8 milionë lekë, me 5 %. Ligji nr.122/2020 neni 11,"PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9632, DATË 30.10.2006, "PËR SISTEMIN E TAKSAVE VENDORE", i ndryshuar,ka hequr nivelin e shkalles se pageses per njesite e qeverisjes vendore dhe te ardhurat nga kjo takse per vitin 2022,

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nëpërmjet drejtorive rajonale tatimore është e ngarkuar me vlerësimin dhe kontrollin e tatimpaguesve, subjekt i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël.

"***Niveli i tatimit për subjektet e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin me qarkullim vjetor nga 0 deri në 8 milionë lekë, është 0 (zero) lekë***".

Tatimit te thjeshtuar mbi fitimin per biznesin e vogël i nenshtrohet cdo subjekt i cili gjate vitit fiskal realizon nje qarkullim vjetor mbi 8(tete) million leke.

Sipas ligjit te ri, shkalla tatimore e aplikueshme mbi fitimin per biznesin e vogel me qarkullim mbi 8 milione leke, eshte 5 perqind e fitimit te realizuar te nje viti me pare.

Për biznesin me xhiro mbi 8 milion lekë, kjo Takse vilet nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Elbasan, e cila mban 1% të shumës të arkëtuar si agjent tatimor.

Drejtoria Rajonale eshte e ngarkuar me vleresimin, mbledhjen, kontrollin, arketimin dhe transferimin ne llogari te buxhetit te qeverisjes vendore te te ardhurave nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit te vogel.

## Deklarimi

Çdo tatimpagues, subjekt i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, është i detyruar që deri më 10 shkurt të vitit që pason periudhën tatimore të dorëzojë një deklaratë vjetore tatimore, ku të jepen hollësisht të ardhurat gjithsej, shpenzimet e zbritshme, fitimi i tatueshëm, si dhe çdo hollësi tjetër e përcaktuar me udhëzim të ministrit të Financave dhe Ekonomisë për plotësimin dhe dorëzimin e deklaratës tatimore vjetore.

## Administrimi i tatimit

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nëpërmjet drejtorive rajonale tatimore është e ngarkuar me vlerësimin dhe kontrollin e tatimpaguesve, subjekt i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël.Administrata rajonale tatimore krijon një regjistër të veçantë mbi biznesin e vogël, në bazë të të dhënave që merr nga bashkitë. Ky regjistër do të përditësohet me hapjen e biznesve të reja.

## Transferimi i të ardhurave në llogaritë e njësive të qeverisjes vendore dhe në buxhetin e shtetit dhe komisioni i agjentit tatimor

Administrata Tatimore Qëndrore transferon të ardhurat nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël në llogari të bashkive, ku ka vendndodhjen biznesi i taksueshëm, brenda datës 10 të muajit pasardhës, kur janë arkëtuar tatimet.

Administrata Tatimore Qëndrore, për shërbimin që kryen, merr një komision. Ky komision llogaritet në përqindje të shumës së tatimit që kanë arkëtuar dhe kanë transferuar në buxhetin e njësive të qeverisjes vendore, i cili është në masën 1 për qind dhe derdhet në llogari të Administratës Tatimore Qendrore.

Komisioni kalon në llogari të Buxhetit të Shtetit, në bazë të legjislacionit në fuqi mbi përdorimin e të ardhurave dytësore, të krijuara në institucionet buxhetore dhe për mbulimin e kostove të "Pullave të tatimit".

## Bashkëpunimi

Drejtoria rajonale tatimore njofton bashkinë jo më pak se një herë në gjashtë muaj për punën e bërë për nivelin e vjeljes së këtij tatimi.
Bashkitë, i kërkojnë organit tatimor kryerjen e veprimeve për plotësimin e detyrave për administrimin e tatimit dhe derdhjen në favor të saj, sipas afatit ligjor të të ardhurave nga tatimi i thjeshtuar i fitimit mbi biznesin e vogël.

## A.2 TAKSA MBI PASURINË E PALUAJTSHME

Takses se pasurise se palujteshme i nenshtrohen te gjithe personat fizik ose juridik,vendas ose te huaj , pronar apo perdorues se pasurise se palujteshme , ne teritorin e RSH, pavarsisht nga niveli I shfrytezimit te ketyre pasurive.Bejne perjashtim rastet kur ne ligj parashikohet ndryshe.
Detyrimin mbi taksen e pasuris se palujteshme e ka, sipas rastit, pronar ose bashkepronare,sipas pjeses qe zoteron,apo perdorues i pasurise se palujteshme ,per pasurite qe nuk jane te paisur me dokumente pronesie .

**Ne taksen e pasurise se palujteshme perfshihen :**

a- **Taksa mbi Ndertesen**
b- **Taksa mbi Token Bujqesore**
c- **Taksa mbi Truallin**

Taksat llogariten si detyrim vjetor i taksapaguesitnese pasuria e paluajtshem krijohet,tjetersohet ose zhduket brenda kesaj periudhe,detyrimi i taksapaguesit llogaritet proporcionalisht vetem per periudhen e se drejtes se pronesise .
**Ne rast te mungese se dokumentit te pronesise** (ndertese,toke bujqesore,truall)perdoruesi i pasurise ka te drejte te beje vetedeklarim te siperfaqes prane Bashkise Prrenjas,e cila ka te drejte qe te ngreje nje komision /grup pune, nga stafi i Drejtorise ser te Ardhurave, i cili ben matjet faktike ne terren te siperfaqes perkatese dhe me pas ky akt-kostatim i kalon per vlersim kesaj drejtoriekonform ligjit "Per Sistemin e taksave dhe tarifave Vendore" , i ndryshuar.

### A2.a)Taksa mbi ndërtesën

Baza e takses eshte siperfaqja ne meter katror e nderteses ose e pjeses se saj , mbi dhe nen nivelin e tokes dhe per cdo kat. Dokumentet qe vertetojne pronesine jane Certifikata e Pronesise,Vendimi i Komisionit te Pronave,Vendimi i Privatizimit etj, dokumentet konform legjislacionit ne fuqi.

- Takses se nderteses i nenshtrohen indivite,persona fizike ose juridike ,vendas ose te huaj, personat qe kane aplikuar per legalizim, personat qe jane ne proces ndertimi sipas lejes se ndertimit , por te pa mbyllur ne kohe
- Vlera e takses per tu paguar per cdo njesi pronesie llogaritet si shumezim i bazes se taksueshme me shkallen e takses.
- Baza e taksueshme eshte vlera e pasurise, e cila llogaritet si shumezim i cmimit per meter katror me siperfaqen e ndertimit ne meter katror.
- Taksa e nderteses llogaritet si detyrim vjetore dhe pagesa e saj do te behet per cdo muaj ose me gjate sipas marrveshjes se arritur me nje nga agjentet tatimor.

- Shkallet e takses se nderteses jane :
  a. 0,005 % per ndertesat per banim
  b. 0,2 % per veprimtari ekonomike
  c. 30 % e shkalles se takses perkatese per te gjitha siperfaqet ndertimore, per te cilat zhvilluesi eshte pajisur me leje ndertimi dhe nuk e ka perfunduar ne afat .

**ÇMIMET MESATARE REFERUESE PËR METËR KATROR SIPËRFAQE NDËRTIMI PËR VLERËSIMIN E VLERËS SË TAKSUESHME PËR BANESAT,**

**ANEKSI 1 A.1.10/45**

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **BASHKIA** | **PRRENJAS** | **41,780** | **LEKE** | **SIPERFAQE SHFRYTEZIMI** |

- Ne paketen fiskale 2023 do te aplikohen koeficentet si me poshte :
  a. Çmimi per banim per bashkine Prrenjas sipas aneksit 1, me 41,780 lek/$m^2$
  b. Çmimi per veprimtari ekonomike sipas aneksit 2 pika me 62,670 lek/$m^2$ pra 1.5 here me i larte se cmimi i siperfaqeve te banimit .***(41,780 *1,5= 62,670 leke/$m^2$.)***
  c. Çmimi i reduktuar ne 35 % per njesite administrative sipas pikes b te aneksit 1 me 27,157 lek/$m^2$ per njesite Qukes,Rrajce,Stravaj.Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi të destinuara për banim në njësitë administrative jashtë qytetit përkatës, të cilat iu bashkuan njësive të vetëqeverisjes vendore pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 115/2014, "Për ndarjen administrativoterritoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë",reduktohet deri në 35% (tridhjetë e pesë) për qind, krahasuar me çmimin e zonës më të afërt, përjashtuar zonat rezidenciale***(41,780-35% = 27,157 leke/$m^2$).***
  d. Çmimi per parkim te mbuluar, bodrume me 29,246 lek/$m^2$ sipas pikes b aneksi 2 eshte 70 % e cmimit te siperfaqeve te banimit sipas aneksit 1 .(41,780 *70 %= 29,246 lek/$m^2$. )
  e. Çmimi per veprimtari industrial prodhim, perpunim ose magazinim te mallrave industrial si fabrika, depo, magazine etj. me 20,890 lek/$m^2$ eshte 50 % e cmimit te siperfaqeve te banimit sipas aneksit 1.
  f. Çmimi per grumbullim, magazinim dhe ruajtje te prodhimeve bujqesore e blektorale dhe parkim te hapur me 12,534 lek/$m^2$ eshte 30 % e cmimit te siperfaqeve te banimit sipas aneksit 1.
  g. Per ndertesat e privatizuara me ligjin 7652 dt 23.12.1992 "per privatizimin e banesave shteterore ", te ndryshuara, cmimi per $m^2$ eshte 70 % e cmimit sipas zonave te tabeles, vetem ne rastin e shitjes se pare .
- Nisur nga ndryshimi i takses se nderteses, ku per familjaret ka nje rritje ne 3-4 fishe dhe per veprimtarit ekonomike shkon me ulje , bazuar ne piken 3 te VKM nr. 132 dt 07.03.2018 me + - 30 % i propozojme Keshillit Bashkiak :
  a. Zbritje te takses se nderteses ne masen - **30 %** per njesite administrative Qukes,Rrajce,Stravaj .
  b. Rritje te takes se nderteses ne **+ 30 %** per ish-bashkine Prrenjas.

Me poshte paraqiten tabelat per taksen e nderteses sipas njesive administrative per banim dhe per aktivitet.

## TABELA E TAKSES SE NDERTESES SIPAS NJESIVE,PER BANIM

| | | Shkalla e taksës së miratuar | | Vlera e taksës për metër katror për banesat që përdoren/shrytëzohen për banim | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Njësia Administrative | Cmimi referencë i miratuar | Familje | Biznese | Shtëpi/ Apartament (1) | Parkim i mbuluar ose bodrum (0.7) | Banesa të privatizuara me ligjin nr. 7652, datë 23.12.1992 (0.7) |
| Prrenjas | 41,780 | 0.04% | 0.26% | 14.62 | 10.24 | 10.24 |
| Qukës | 27,157 | 0.04% | 0.14% | 9.5 | 6.65 | 6.65 |
| Rrajcë | 27,157 | 0.04% | 0.14% | 9.5 | 6.65 | 6.65 |
| Stravaj | 27,157 | 0.04% | 0.14% | 9.5 | 6.65 | 6.65 |

## TABELA E TAKSES SE NDERTESES SIPAS NJESIVE,PER AKTIVITET

| | | Shkalla e taksës së miratuar | | Vlera e taksës për metër katror për ndërtesat që përdoren/shfrytëzohen për zhvillim aktiviteti | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Njësia Administrative | Cmimi referencë i miratuar sipas VKM | familje | biznese | Njësi tregtimi dhe shërbimi (1.5) | Parkim i mbulua r ose bodrum (0.7) | Parkim i hapur (0.3) ose Ambjent Sportiv | Njësi industriale prodhim magazinim (0.5) | Njësi që përdoren për bujqësi ose blegtori (0.3) |
| Prrenjas | 41,780 | 0.04% | 0.26% | 162.94 | 76.04 | 32.59 | 54.31 | 32.59 |
| NJESIA Qukës | 27,157 | 0.04% | 0.14% | 57.0297 | 26.61386 | 11.40594 | 19.0099 | 11.40594 |
| NJESIA Rrajcë | 27,157 | 0.04% | 0.14% | 57.0297 | 26.61386 | 11.40594 | 19.0099 | 11.40594 |
| NJESIA Stravaj | 27,157 | 0.04% | 0.14% | 57.0297 | 26.61386 | 11.40594 | 19.0099 | 11.40594 |

### Kategorizimi i ndertesave;

a.**Ndertesa banimi** konsiderohenatondertesa, te cilat perdoren nga qytetaret vetem per qellime banimi dhe jo per qellime fitimprurese si dhe ndertesat ne pronesi te shoqerive te ndertimit te pashitura, por te hipotekuara si ndertesabanimi.

b.**Ndertesa per tregeti dhe sherbime**, perfshi dhe zyra, konsiderohen ato ndertesa, te cilat shfrytezohen nga pronaret e tyre per qellime fitimprurese, qe ushtrojne aktivitete private ne fushen:

- e tregtise, si tregtim industrial dhe ushqimore, fruta perime, etj te ngjashme me to.
- te sherbimeve, si Agjensi bankare, kembimi valute, doganore, hoteleri-turizem, turizem familjar, palestra, fitnes, pishina te hapura e te mbyllura, qendra shitje karburanti, farmaci, klinika, spitale, agjenci sigurimesh, agjenci transporti, autoservise, autotoshkolla, Lavanteri, pastrim kimik, rojet civile, salla lojra te ndryshme, marangoz, riparime te ndryshme, parukeri / floktore, rrobaqepesi,etj te ngjashme meto.
-profesione te lira,si avokat,noter,studio konsulence,ekonomist,inxhinier,mjek,fondacione te ndryshme, etj te ngjashme me to.

c.**Ndertesa per prodhim,perpunim ose magazinim** te mallrave industriale dhe ushqimore,duke perfshire fabrikat, depot, magazinat, perpunim duralumini ,metalesh ,druri,letra kartoni, shtypshkronje, tullalla, tjegulla, prodhime ushqimore, furre buke, prodhim konfeksione, prodhim dhe perpunim vajra, karburante, etj,prodhim dhe perpunim produkte farmaceutike objekte te tjera te ngjashme me to.

d. **Ndertesa per parkim:**
-te mbuluara, konsiderohen ato ndertesa, qe perdoren per ushtrimin e aktivitetit si sherbim parkimi per te tretet, ne ambjentet te mbyllura ose nentokesore.
-te hapura konsiderohen ato ndertesa, qe perdoren per ushtrimin e aktivitetit si sherbim parkimi per te tretet, ne ambjente tehapura.
e.**Ndertesa,qe perdoren per bujqesi dhe blegtori**,apo veprimtari mbeshtetese,si:
-grumbullim, magazinim dhe ruajtje te produktevc bujqésor dhe blegtorale,
-konsiderohen ato ndertesa sistalla per bageti,
-magazina te ruajtjes se produkteve bujqesore e blegtorale,bimeve medicinale,etj te ngjashme me to.

**- Perjashtohen nga taksa e nderteses**
Bazuar në ligjin 106/2017 neni 22 pika 6, përjashtohen:
a) pronat e shtetit dhe të njësive të qeverisjes vendore, që përdoren për qëllime jofitimprurëse;
b) pasuritë në pronësi të shtetit, të kaluara me vendim të Këshillit të Ministrave, nën administrimin e shoqërive publike shtetërore;
c) ndërtesat e banimit, që shfrytëzohen nga qiramarrësi me qira të paliberalizuara;
ç) banesat sociale në pronësi të bashkive;
d) pasuritë e paluajtshme-ndërtesa, pronë e subjekteve juridike ose fizike, që në bazë të marrëveshjeve me bashkitë përdoren nga këto të fundit si banesa sociale;
dh) ndërtesat që përdoren nga komunitetet fetare, në funksion të veprimtarisë së tyre;
e) strukturat akomoduese "Hotel/Resort me katër dhe pesë yje, status special", sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht "brand name";
ë) ndërtesat e banimit, të deklaruara si vendbanim nga kryefamiljarët që përfitojnë pension pleqërie/pension social, kur familja e tyre përbëhet vetëm nga pensionistë, ose dhe me persona në ngarkim të tyre, që janë të pa aftë për punë;
f) ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që trajtohen me ndihmë ekonomike;
g) ndërtesat kulturore, nën mbrojtje të përkohshme ose të përhershme, për kohën në të cilën deklarohet mbrojtja, sipas legjislacionit në fuqi për monumentet e kulturës dhe/ose trashëgiminë kulturore, të cilat përdoren vetëm për qëllime jofitimprurëse.

Dokumentat qe vertetojne per perjashtimin nga taksa e nderteses:

a. Zyrat e ndihmes ekonomike per kryefamiljaret qe trajtohen me ndihme ekonomike, te dorzoje prane zyres se tatim-taksave, listen e kryefamiljareve me dt 30 te cdo muaji, duke filluar nga dt 30 dhjetor 2022 e ne vazhdim.

b. Per pensioniste, pa person tjeter, duhet te dorezohet, certifikata familjare, libreze pensioni ose vertetim nga sigurimet shoqerore.

c. Per qiramarresit, kontrata e qirase.

**Ne rastet e mungese ose mos paraqitjes se dokumentacionit per pronesine mbi ndertesat:**

a. Kategoria "familjare" kane detyrim te paraqesin prane Drejtorise se te Ardhurave certifikaten e pronesise se baneses, mbi bazen e se ciles do te behet faturimi per taksen mbi ndertesen.

**Ne rast mosparaqitje te ketij dokumentacioni atehere do te faturohet per nje siperfaqe banese prej 100 $m^2$.**

b. Strukturat pergjegjese per vjeljen e takses mbi ndertesen do ti referohen VKM nr.132, date 07.03.2018 "Per metodologjine per percaktimin e vleres se taksueshme te pasurise se paluajtshme "ndertesa" , e bazes se takses per kategori specifike,natyren dhe prioritetin e informacionit dhe te dhenave per percaktimin e bazes se takses si dhe kritereve dhe rregullave per vlersimin alternativ te detyrimit te takses".

c. Ne rastet e konstatimit te mosdeklarimit te sakte te siperfaqes se ndertese ne perdorim nga ana e subjektit atehere zbatohen procedurat e ligjit nr.9920 fate 19.05.2008, Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise , i ndryshuar, neni 116.

**Struktura pergjegjese** per vjeljen e takses mbi ndertesat per kategorite "biznes" dhe "familjare" eshte Drejtoria e te Ardhurave dhe Licensave pranë Bashkisë Prrenjas , administratorët e lagjeve (për njësinë administrative Prrenjas kurse për njësitë e tjera administrative struktura e ngarkuar është njësia administrative.

- Aftet e pageses se takses:
  - Per kategorine "Biznes" ky detyrim paguhet vetem me nje kest,ku data e fundit eshte ***30.09.2023.***
  - Per kategorine "Familjare", taksa e nderteses do te paguhet me nje kest te vetem, deri në ***datën 31.12.2023.***
  - Për mospagesë në afatin e caktuar per kategorine biznese/institucione do të zbatohen procedurat për marrjen e masave të detyrimit tatimor sipas ligjit nr 9920, date 19,05.2008, "Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperisë" dhe do të aplikohet gjobë në masën 1.8% çdo muaj vonesë ose 0.06 % shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer por jo më shumë se 12 muaj ose 365 dite.
  - Përjashtohen nga pagesa e gjobës për vonesë në pagesë të gjithë taksapaguesit familjarë.
  - Afati i njoftimit të tatimpaguesit do të jetë deri në datën **30.04.2023.**
  - Zyra e tatim-taksave eshte pergjegjese per administrimin e takses se nderteses , mbledhjen dhe menaxhimin e informacioneve , perditson te dhenat ne regjistrin qendror te baza e te dhenave te pasurise se palujteshme ( kadastra fiskale )
  - Drejtoria e Planifikimit dhe Mbrotjes se Territorit (Urbanistika ), duhet te paraqese prane Drejtorise se te Adhurave cdo certifikate perdorimi dhe Leje Ndertimi te perfunduar , me qellim qe taksimi i nderteses te jete sa me i drejte dhe i sakte.

## A2. b)TAKSA MBI TOKËN BUJQËSORE.

*"Tokë bujqësore"* është toka e përcaktuar si e tillë në regjistrin e zyrave të regjistrimit të pasurisë.

- **Baza e taksës** është sipërfaqja e tokës bujqësore, në hektar, në pronësi apo në përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e tokës përcaktohet mbi bazën e dokumentave të pronësisë, formularitnr.6, aktit të marrjes së tokës nëpronësi, çertifikatës së regjistrimit të tokës. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i tokës bujqësore bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së tokës bujqësore, pranë bashkisë ku ndodhet toka.Pas vetëdeklarimit Zyra e Tatim – Taksave mund të bëjë verifikimin në lidhje me saktësinë e këtij deklarimi dhe në raste të konstatimit të deklarimit të ndryshëm me realitetin pagesa do përllogaritet për të gjithë periudhën.

- **Niveli i taksës mbi tokën bujqësore** caktohet në lekë për hektar. Detyrimi i taksës llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tatueshme.

- **Kategoritë** minimale të bazës së taksës dhe nivelet treguese të taksës për çdo kategori ne Bashkinë Prrenjas janë si vijon:

Aneksi nr.2, Zona 3.

| Klasifikimi sipas kategorisësë tokës bujqësore | Vlera e taksës nëlekë/ Ha/vit |
|---|---|
| I | 2800 |
| II | 2100 |
| III | 1400 |
| IV | 1350 |
| V | 1250 |
| VI | 1200 |
| VII-X | 1100 |

- **Afatet e pageses**: Detyrimi per taksen mbi token bujqesore eshte vjetor. Per te gjitha kategorite ky detyrim paguhet me nje kest.
- Afati i pageses eshte data **31.12.2023**.
- **Përjashtohen nga taksa tokat bujqësore**, që mbillen me kultura drufrutore dhe vreshtari për **pesë vite te para** nga çasti i mbjelljes.
- **Lehtesira fiskale** do te kete vetem per familjet qe paguajne taksen mbi token bujqesore deri me 31 Dhhjetor 2023 do te kene nje zbritje prej 30 % ***(vetem detyrimi i vitit 2023, pjesa e debise do te paguhet 100%).***
- **Struktura e ngarkuar** për vjeljen e taksës mbi tokën bujqësore është Drejtoria e te Ardhurave dhe Licensave pranë Bashkisë Prrenjas dhe zyrat e tatim taksave prane Njesive Administrative.
- **Afati i njoftimit** të tatimpaguesit do të jetë deri në datën 30.04.2023.
- Afati i pageses eshte **Struktura e ngarkuar** për përllogaritjen dhe vjeljen e këtyre tarifave është Drejtoria Sherbimeve dhe sektori i mirembajtjes se rrugeve rurale.

- **Afati i pageses** do te jete vetem me nje kest ku afati i fundit eshte data 31.12.2023 ku te jene likujduar te gjitha detyrimet.
-

## A 2.c)TAKSA MBI TRUALLIN

| Taksa mbi truallin | Njësia | Vlera e propozuar ne VKB 2022 |
|---|---|---|
| Për qëllime banimi nga individët | Lekë/m²/vit | 0,42 |
| Për qëllime biznesi | Lekë/m²/vit | 18 |

- **Baza e taksës**: Është sipërfaqja e truallit, në metër katror, në pronësi apo përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e truallit në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i truallit bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së truallit në përdorim, pranë bashkisë ku ndodhet trualli.
- **Niveli i taksës** mbi truallin paraqitet si më poshtë:

**Tabelë . Niveli i taksës mbi truallin**

- **Detyrimi për pagesë:** Detyrimi për taksën mbi truallin është vjetor.
- Drejtoria e të ardhurave kryen llogaritjen në bazë të sipërfaqes dhe vlerës së taksës sipas tabelës dhe klasifikimit më sipër.
- Per kategorine **"Biznes"** ky detyrim paguhet vetem me nje kest ku data e fundit eshte **30.09.2023.**
- Per kategorine **"Familjare"**, taksa e nderteses do te paguhet me nje kest te vetem, deri në datën **31.12.2023.**
- **Strukturat përgjegjëse për vjeljen e taksës :**
- Familjarët, faturohen direkt nga Drejtoria e te Ardhurave në Bashkinë me bazë vjetore.
- Detyrimi për biznesin llogaritet nga Drejtoria e të Ardhurave dhe shlyhet pranë çdo banke të nivelit të dytë, ose ne sportelet e Posta Shqiptare sh.a sipas afateve te percaktuara.

- **Dokumenti/Vërtetimi i pronësisë për efekt të detyrimit për pagimin e taksave:**
- Për efekt të detyrimit për pagimin e taksave të taksapaguesit, zyrat e taksave të bashkisë duhet të njohin dokumentet e vërtetimit të pronësisë, sipas regjistrit të zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme u japin të dhëna, pa shpërblim, bashkive dhe për pasuritë e paluajtshme të regjistruara pranë tyre. Zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme njoftojnë rregullisht, çdo 3 muaj, bashkitë dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Taksës së Pasurisë për regjistrimet e reja të kryera dhe ndryshimet e gjendjes së pronave. Nëse prona nuk është e regjistruar në regjistrin e pasurisë së paluajtshme, për efekt të detyrimit për pagimin e taksës nga taksapaguesit, zyrat e taksave të bashkisë, për vërtetim pronësie njohin vërtetimin e pronësisë, vendimet e komisionit të kthimit dhe kompensimit të pronës, vendimet e privatizimit ose dokumentet e tjera, të lëshuara

nga organet përkatëse shtetërore, në përputhje me legjislacionin përkatës.

- **Struktura e ngarkuar për vjeljen** e taksës mbi truallin për biznesin është zyra e tatim taksave pranë Bashkisë Prrenjas.
- Pagesa do te kryhet prane arkes se Bashkise dhe arkes se Njesise Administrative ku banon.
- Ispektori i ngarkuar nga sektori i per taksat dhe tarifat e qytetit Prrenjas do te jete pergjegjesi per ndjekje dhe vjelje e ketyre detyrimeve.
- **Akt-detyrimet** per taksen e pasurise se palujteshme per Bashkine Prrenjas dhe njesite administrative do te plotesohen dhe shperndahen deri me 30.04.2023.

## A.2 d) TAKSA E FJETJES NË HOTEL

- **Përkufizimi**: Strukturat akomoduese do të përfshijnë kategoritë si më poshtë: a)"Bujtinë"; b)"Fjetinë" (Hostel); c)"Kamping"; ç)"Hotel"; d)"Motel"; dh)"Resort"; e)"Qendër kurative"; ë)"Fjetje dhe mëngjes" (B&B).

Secila kategori e strukturave akomoduese klasifikohet me sistem të veçantë, e shoqëruar me shenjat dalluese përkatëse, sipas përcaktimit të mëposhtëm: "Bujtinë" Standard,
"Fjetinë" Standard, Komfort; "Kamping"Standard, "Hotel" dy yje, tre yje, katër yje, pesë yje; "Motel" Standard, Komfort, Superior; "Resort" tre yje, katër yje, pesë yje; "Qendër kurative" dy yje, tre yje, katër yje, pesë yje; "Fjetje dhe mëngjes" (B&B)Standard, Komfort, Superior.

- **Baza e taksës** së fjetjes në hotel është numri i netëve të qëndruara në hotel,për person.
- **Niveli i taksës** paraqitet si më poshtë:

Aneksi 8

| Kategoritë minimale të taksës së fjetjes në hotel | Bashkia Prrenjas |
|---|---|
| Hotelet 4-5yje | 105 lekëpërnatë fjetje |
| Bujtinë, fjetinë, motel dhe çdo njësi tjetëra komoduese, sipas përcaktimeve të ligjit për turizmin. | 35 lekë/ për natë fjetje |

- **Detyrimi dhe këstet e pagimit:** Detyrimi për taksën llogaritet si ***shumëzim i nivelit të taksës së vendosur nga bashkia, për natë qëndrimi,*** me numrin e netëve të qëndrimit në hotel.
  Detyrimi për taksën i takon klientit që strehohet në hotel, detyrim i cili mbahet nga hoteli për llogari të bashkisë, në territorin e së cilës ndodhet hoteli.
  Në faturën e hotelit shënohet çmimi i fjetjes dhe mbi të vlera e taksës.
- **Afati e menyra pagesave**: Derdhja e të ardhurave për këtë taksë nga hoteli në favor të bashkisë,
  Kjo pagese duhet te jete e barazvlefshme me te dhenat e mbajtura ne "Regjistrin e Fjetjes" ne hotel, te cilat paraqiten per konfirmim tek Drejtoria e te Ardhurave dhe Licensave sa here, qe i kerkohet nga kjo e fundit. "Regjistri i Fjetjes" i cdo subjekti, qe ushtron aktivitetin ne fushen e sherbimit te hotelerise, duhet te jete sekretuar dhe certifikuar nga Bashkia Prrenjas. Ne rastet e mosparaqitjes se ketij regjistri, Drejtoria e te Ardhurave ben nje vlersim paraprak, duke marre per baze numrin e dhomave me nje numer minimal prej 2(dy) personash per cdo dhome, me baze ditore, per periudhen qe subjekti eshte aktiv ne sistemin tatimor.

- **Sanksione:** Tatimpaguesi, i cili nuk arrin që, brenda afatit të parashikuar, të paguajë shumën e detyrimit tatimor e të kontributit, detyrohet të paguajë një gjobë, të barabartë me 0,06 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast, gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike.
- **Afati i njoftimit tatimpaguesit**: 30.04.2023.
- **Struktura e ngarkuarpërvjeljenetaksës :** Eshtë Drejtoria e te Ardhurave dhe Licensave prane Bashkisë Prrenjas.

## A.4 TAKSA E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË NGA NDËRTIMET E REJA.

1. **Baza e taksës** është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet ose vlera në lekë e çmimit të shitjes për metër katror të investimit të ri. Klasifikimi si investimi ri përcaktohet në përputhje m elegjislacionin në fuqi për dhënien e lejes së ndërtimit.
2. Për ndërtime që destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, të industrisë, të bujqësisë, të ndërtimeve individuale për qëllime të përdorimit vetjak nga individët, të ndërtuara nga vetë individi apo me sipërmarrës, si dhe të ndërtimeve për qëllime publike, taksa e ndikimit në infrastrukturë është 1-3 për qind e vlerës së investimit,ne bashkine Prrenjas do te aplikohet niveli si me poshte :
   - Per ndertimet familjare do te jete **1 %**
   - Ndertimet per efekt biznesi **2 %**.
3. Për projekte te infrastrukturës, Për ndërtimin e rrugëve kombëtare,të porteve,aeroporteve,tuneleve,digave,ndërtimit të infrastrukturës në energji,përfshirë makineritë dhe pajisjet për këto projekte,taksa e ndikimit në infrastrukturë të ndërtimeve të reja është 0,1 përqind e vlerës së investimit,por jo më pak se kostoja e rehabilitimit të infrastrukturës së dëmtuar, kur kjo kosto nuk është përfshirë në preventivin e investimit.
4. Për ndërtesat,të cilat janë në proces legalizimi,taksa e ndikimit në infrastrukturë e ndërtimeve të reja është **0,5%**e vlerës së investimit.
5. Për ndërtimet në proces legalizimi,objekti i dytë,taksa e ndikimitnë infrastrukturë do të llogaritet si ndërtime te reja që trajtohen me Leje ndërtimi sipas (Pikes 2 dhe 3).
6. Detyrimi përpagesën e taksës i takon investitorit.
7. Miratimin e takses se ndikimit ne infrastrukture ne rastin e ndertimeve te distinuara per qellim banimi apo njesi sherbimi, te cilat kryhen nga shoqeri ndertimi, (referuar ligjit 95/2018, neni 9 pika 2 , shkalla e takses eshte 4 deri 8 per qind te cmimit te shitjes per meter katror).Per bashkine Prrenjas per kete kategori do te aplikohet niveli nga 4-6 % te cmimit te shitjes per meter katror.Në këtë kategori investimesh përfshihen edhe ndërtimet zëvendësuese për qëllime banimi, të kushtëzuara për t'u ndërtuar si shkak i zbatimit të një kontrate koncesionare, e cila prek banesat ekzistuese.Gjithashtu, në këtë kategori përfshihen edhe ndërtimet e destinuara për qendra tregtare apo të biznesit.
8. Në rastin e ndërtimeve, të ndryshme nga ato të përcaktuara në pikën 2, të nenit 9, niveli i taksës shprehet si përqindje e vlerës së investimit dhe :

a) për projekte të infrastrukturës, për ndërtimin e rrugëve kombëtare, të porteve, të aeroporteve, të tuneleve, të digave, të ndërtimit të infrastrukturës në energji, përfshirë makineritë dhe pajisjet për këto projekte, taksa e ndikimit në infrastrukturë të ndërtimeve të reja është 0,1 për qind e vlerës së investimit, por jo më pak se kostoja e rehabilitimit të infrastrukturës së dëmtuar, kur kjo kosto nuk është përfshirë në preventivin e investimit;

- **Struktura e ngarkuar** për përllogaritjen,vjeljen dhe lëshimin e autorizimit për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja,është Drejtoria e Urbanistikes dhe Zbatimt te Politikave te BE pranë Bashkisë Prrenjas.

APLIKIMET

| Llojet e Aplikimeve | TARIFA E PERCAKTUAR |
|---|---|
| 1. Deklarata paraprake punimeve (me nje ndalese) | 10,000 leke/deklarate |
| 2. Leje ndertimi(me nje ndalese) | 3,000 leke |
| 3. Planvendosje | 3,000 leke |
| 4. Planimetri | 3,000 leke |
| 5. Leje per shtyrje afati | 3,000 leke |
| 6. Ndryshim destinacioni | 2,000 leke |
| 7. Leje shfrytezim objekti | 50 leke/m2 |
| 8. Mur i jashtem | 15 leke/m2 |
| 9. Certifikat Perdorderimi | 5,000 leke |
| 10. Leje per nderhyrje , ku nuk kerkohet leje ndertimi | 3,000 leke |
| 11. Kerkese per leje zhvillimi per struktura banimi individuale | 2,000 leke |

**Pagesa** e tarifave do të kryhet pas miratimit të vendimit dhe para zbardhjes se lejes se ndertimit, si dhe pas pageses se te gjitha detyrimeve te tjera ( Taksa dhe tarifa vendore) .

- **Struktura e ngarkuar** për përllogaritjen,vjeljen dhe lëshimin e autorizimit për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja,është Drejtoria e Urbanistikes dhe Zbatimt te Politikave te BE pranë Bashkisë Prrenjas.
- Detyrimi për pagesën e taksës i takon investitorit.
- Nëse objekti, për të cilin do të bëhet investimi, shtrihet në territorin e më shumë se një bashkie ose kur objekti ndikon në infrastrukturën e një bashkie tjetër, të ardhurat nga taksa ndahen proporcionalisht ndërmjet tyre, në përputhje me raportet përkatëse të shtrirjes së objektit dhe të ndikimit të investimit në infrastrukturën e secilës bashki.
- Pagesa e taksave do të kryhet dhe fatura do të ngarkohet në sistemin elektronik ku është aplikuar për leje ndërtimi brenda 15 ditëve nga njoftimi. Në rast mospagese, kërkesa për leje ndërtimi refuzohet.
- Drejtoria e Kontrollit të Zhvillimit te Territorit përcakton objektet, sipërfaqen, numrin e

kateve etj,e cila hap pas hapi përcjell informacionin dhe llogaritjen e detyrimit tek Drejtoria përgjegjëse për të ardhurat.

- Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës së shërbimeve është Drejtoria përgjegjëse për të ardhurat.

## A.5 TAKSA E TABELËS

- **Baza e taksës:** Taksa e tabelës aplikohet për të gjitha subjektet që duhet të vendosin emërtimin e subjektit në pamjen ballore të njësisë ku zhvillojnë veprimtarinë, në hapësira të tjera publike tëlejuara ose private, qofshin këto të lëvizshme ose të palëvizshme dhe që shërbejnë për qëllime identifikimi.
- Kjo taksë aplikohet për të gjitha subjektet fizike,juridike,private e shtetërore,vendas apo të huaj që kryejnë veprimtarinë e tyre brenda territorit të Bashkise Prrenjas.
- **Niveli i taksës** për Bashkine Prrenjas ështësi më poshtë vijon:

Taksa e Tabeles Sipas Kategorive Te Bashkive

Aneksi 7

| Nr | Llojet e tabelave | Nj/matese | Bashki kat. I | Bashki kat.II | Bashki kat.III |
|---|---|---|---|---|---|
| I. | Takse tabele per qellime identifikimi, te trupezuara ose jo, brenda territorit, ku zhvillohet veprimtaria e biznesitdhe qe nuk perdoren per te reklamuar veprimtarite e te treteve ( ku shenohet emri dhe/ ose aktiviteti I biznesit | | | | |
| A | Deri ne 2 $m^2$ | leke/ $m^2$/vit | | | 0 |
| B | Mbi 2 $m^2$ deri 10 $m^2$ | | | | |
| | E thjeshte (pa ndricim) | leke/ $m^2$/vit | | | 7,000 |
| | Me ndricim te thjeshte | leke/ $m^2$/vit | | | 11,500 |
| | Elektronike | leke/ $m^2$/vit | | | 15,000 |
| C | Mbi 10 $m^2$ deri 20 $m^2$ | | | | |
| | E thjeshte( pa ndricim) | leke/ $m^2$/vit | | | 5,950 |
| | Me ndricim te thjeshte | leke/ $m^2$/vit | | | 9,775 |
| | Elektronike | leke/ $m^2$/vit | | | 12,750 |
| Ç | Mbi 20 $m^2$ deri 40 $m^2$ | | | | |
| | E thjeshte( pa ndricim) | leke/ $m^2$/vit | | | 3,850 |
| | Me ndricim te thjeshte | leke/ $m^2$/vit | | | 6,325 |
| | Elektronike | leke/ $m^2$/vit | | | 8,250 |
| D | Mbi 40 $m^2$ | | | | |
| | E thjeshte( pa ndricim) | leke/ $m^2$/vit | | | 2,800 |
| | Me ndricim te thjeshte | leke/ $m^2$/vit | | | 4,600 |
| | Elektronike | leke/ $m^2$/vit | | | 6,000 |
| II. | Tabele per qellime identifikimi jashte territorit ku zhvillohet veprimtaria e biznesit ne formen dhe permasat e tabelave per orientim | | | | |
| | Tabele identifikuese | leke/ $m^2$/vit | | | 120 |
| III. | Tabele per qellime reklamimi e levizshme e palevizshme | | | | |
| | E thjeshte( me/pa ndricim) | leke/ $m^2$/vit | | | 13,500 |
| | Elektronike | leke/ $m^2$/vit | | | 27,000 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| IV. | Tabela ne funksion te ekspozimeve te ndyshme te hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola, etj | | | | |
| | Te te gjitha llojeve dhe permasave | leke/ $m^2$/vit | | | 1,000 |

- **Detyrimi i kësaj takse është vjetore** dhe pagesa bëhet paralelisht me pagesën e taksave dhe tarifave të tjera.
- **Afatet e pagesës:** Derdhja e të ardhurave për këtë taksë në favor të bashkise.
  1. Për subjektet ekzistuese detyrimi paguhet vetem me nje kest ku data e fundit do te jete ***30.09.2023***
  2. Për subjektet e reja detyrimi tatimor do të llogaritet që nga muaji korrent që subjekti regjistrohet pranë QKR dhe paguhet menjëherë.
  3. Taksa e tabelës për qëllime identifikimi paguhet për çdo njësi ku subjekti zhvillon aktivitetin nga muaji korrent që regjistrohet pranë QKR.
  4. Për subjektet e reja detyrimi llogaritet dhe paguhet menjëherë sipas periudhës së përcaktuar në kontratën e nënshkruar me strukturat përkatëse të Bashkisë.
  5. Për "kategorinë 4" detyrimi llogaritet sipas ditëve të përcaktuara në lejen përkatëse të lëshuar nga strukturat përkatëse të Bashkisë dhe paguhet menjëherë.

**Sanksione:**

- Tatimpaguesi, i cili nuk arrin që,brenda afatit të parashikuar, të paguajë shumën e detyrimit tatimor të kontributit,detyrohe ttë paguajë një gjobë, të barabartë me 0,06 për qind të shumëssë detyrimittë papaguar për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer.Në asnjë rast,gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike.
- **Strukturaengarkuar përdhënie leje** për të vendosur tabelë reklamuese ështe IKMT pranë Bashkise Prrenjas bazuar n ëkërkesën e subjektit që do tëvendosë tabelë reklamuese.
- **Struktura e ngarkuar përvjeljen** e kësaj takse është zyra e tatim taksave.
- **Strukturae ngarkuar për penalitetet** pë rmos pajisje me lejë për vendosje tabele reklamuese është Policia Bashkiake.
- **Afati i njoftmit tatimpaguesve** do te jete brenda dates30.04.2023.

## KAPITULLI II

## TAKSAT E NDARA

"Taksë ose tatim i ndarë" është një taksë kombëtare ose tatim i përcaktuar sipas ligjit për procedurat tatimore ose ligjeve të veçanta tatimore, të ardhurat respektive prej të cilave ndahen, plotësisht ose pjesërisht, me njësitë e vetëqeverisjes vendore. Njësitë e vetëqeverisjes vendore marrin një përqindje nga taksat ose tatimet kombëtare që realizohen në juridiksionin e tyre. Të ardhurat e arkëtuara nga taksat e ndara transferohen te njësitë e vetëqeverisjes vendore deri në fund të muajit pasardhës. Në rastet e ndryshimeve në politikën fiskale, që shoqërohen me ulje të niveleve, normave dhe taksave të ndara, njësitë e vetëqeverisjes vendore kompensohen financiarisht, në përputhje me nivelin e uljes së të ardhurave.

Ne taksat e ndara bejne pjese :

a. Taksa Vjetore E Mjeteve Të Përdorura.
b. Taksa e Rentës Minerare
c. Taksa Mbi Kalimin e se Drejtes se Pronesise Per Pasurine E Paluajtshme
d. Të Ardhura Nga Tatimi Mbi Të Ardhurat Personale

## II-A. TAKSA VJETORE E MJETEVE TË TRANSPORTIT RRUGOR.

- **Baza e taksës:** Lloji i mjetit të transportit rrugorë eshtë bazë për taksën: Cilindrata në $cm^3$ x koeficientin fiks sipas vjetërsisë x taksa fikse për llojin e karburantit.
- **Detyrimi** për pagimin e taksës i takon pronarit të mjetit.
- **Drejtoritë Rajonale të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimevetë Transportit Rrugor** (DRSHTRR),janë agjent tatimor të mbledhjessë taksës vjetore të mjeteve të përdorura.
- **Afati** i derdhjes se takses mujore te mbledhur nga kjo drejtori, është brenda datës 30 të çdo muaji,për llogaritë organeve tatimore të administratës qendrore dhe njësive të qeverisjes vendore, mbështetur nëvendbanimine taksapaguesit që zotëron mjetin e transportit.
- Nga shuma e përgjithshme e të ardhurave mujore të arkëtuara nga taksa vjetore e mjeteve të përdorura,drejtoritërajonale të DPSHTRR-së,pasi mbajnë komisioninprej 5(pesë)% të totalit mujor të të ardhurave, derdhin me anë të faturës për arkëtim, 25 % të këtyre të ardhurave nëllogari në bankare të degës së thesarit të rrethit,ku është njësia e qeverisjes vendore.
- Rakordimi i pagesëssë taksës ndërmjet strukturave të DRSHTRR-së me organet tatimore të administratës qendrore dhe vendore kryhet në bazë të regjistrit ditor të taksës vjetore të mjeteve të përdorura,formati i të cilit është i përcaktuar me udhëzimtë Ministrit të Financave.
- **Struktura e ngarkuar** për vjeljen e kësaj takse është Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor.

## II-B RENTA MINERARE

- **Baza e taksës:** Çdo person fizik apo juridik, që është i liçencuar dhe/ose vepron në industrinë minerare, sipas një marrëdhënieje kontraktuale me ministrin përgjegjës për ekonominë, duhet të paguajë rentë minerare për burimet natyrore që nxjerr nga nëntoka. Renta minerare llogaritet si detyrim mujor i subjektit taksapagues, në çastin kur ai shet produkte minerare.
- **Strukturat përgjegjëse për vjeljet e taksës:**Degët e doganave në rrethe ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente, në rastin e eksportit të produkteve minerare, ndërsa degët e tatimeve ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente, në rastin e shitjes së produkteve minerare brenda vendit. 5 për qind e të ardhurave nga renta minerare i takojnë Bashkisë Prrenjas, ku zhvillohet veprimtaria.

- **Agjent tatimor**: Bazuar ne ligjin 9975 dt 28.07.2008 " Per taksat kombetare " i ndryshuar Drejtorite Rajonale Tatimore dhe Deget e Doganave jane Agjent tatimor te kesaj takse.
- **Afati i pagesave**: Brenda dates 30 te cdo muaji, agjentet tatimor dergojne informacion analitik prane Drejtorise se Pergjithshme te buxhetit ne Ministrine e Financave , per vleren e rentes minerare te mbledhur, dhe subjektin tatimore sipas njesivee te qeverisjes vendore ku ushtrojne aktivitetin (*sipas formularit 9*).
- **Derdhja e detyrimit nga agjentet**: Pjesa e te ardhurave nga renta minerare, 5 % te saj e percaktuar me ligj, i takon njesise se qeverisjes vendore, dhe shperndahet nga struktura pergjegjese e buxhetit ne Ministrin e Financave. Ministria e Financave njofton zyrtarisht drejtorine rajonale te tatimeve/doganave, respektive, dhe njesine e qeverisjes vendore, per masen e llogaritur te shperndarjes se te ardhurave nga renta minerale. Drejtoria Rajonale e tatimeve dhe Doganave paraqesin kerkese per transferimin e fondit ne degen perkatese te thesarit. Dega e thesarit ku ndodhet Drejtoria Rajonale tatimore e tatimpaguesit procedon, duke perdorur metoden e transferimeve te brendeshme ne sistemin informatizuar financiar te Qeverise.

## II-C TAKSA MBI KALIMIN E SË DREJTËS SË PRONËSISË PËR PASURITË E PALUAJTSHME

Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme vendoset për ndërtesat dhe të gjitha pasuritë e paluajtshme në çastin e kalimi ttë së drejtës së pronësisë mbi to.

- **Taksa** paguhet nga personi,që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, para kryerjes së regjistrimit, në përputhje me aktet ligjore në fuqi.
- **Baza e taksës** mbi kalimin e së drejtëssëpronësisë përndërtesat është sipërfaqja e ndërtimit,pronësia e së cilës transferohet.Niveli i taksës caktohet në lekë për metër katror të bazës së taksës.
- **Detyrimi tatimor** llogaritet si shumëzimi i nivelit të taksës me bazën e tij.

Aneksi nr. 3, Zona 3.

| **Kategoritë Ndërtesave** | Njesia administrative Bashkia Prrenjas |
|---|---|
| | **Zona 3 (Lekë/m2)** |
| I.Ndërtesabanimi | 100 |
| II.Ndërtesatetjerapërtregti dheshërbime | 300 |
| III.Ndërtesatëtjera | 200 |

***Shënim:****Në të gjitha njësitë administrative të tjera zbatojnë nivelin e taksës për zonën 3*

**Struktura e ngarkuar për vjeljen e kësaj**

Struktura e ngarkuar për vjeljen e kësaj takse është Zyra Vendore e Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, e cila në rolin e agjentit tatimor, përfiton 3 për qind të shumës së arkëtuar dhe diferencën e derdhin për llogari të buxhetit përkatës të bashkisë, në territorin e së cilës ndodhet pasuria, jo më vonë se data 30 e muajit pasardhës.

**Perjashtime:**

-Perjashtohen nga pagimi i takses e se drejtes se pronesise per pasurite e paluajtshme :

a) Enti Kombetar i Banesave, Ministria e Financave dhe organet e qeverisjes qendrore e vendore
b) Personat, te cilet jane subjekt i tatimit mbi te ardhurat vetjake, mbeshtetje te ligjit nr. 8438, date 28.12.1998 "Per Tatimin mbi te Ardhurat"
c) Subjektet, qe dhurojne pasuri te paluajtshme kur perfitues te drejteperdrejte jane:
    1. Institucionet dhe entet shteterore e publike, qendrore e vendore;
    2. Bashkesite fetare ose organizatat Jofitimprurese , kur dhurimi lidhet me ate pjese te veprimtarise se tyre pa qellim fitimi.Ne keto raste dhuruesi ,pasi ka marre vertetim nga Keshilli Bashkiak per perjashtimin nga taksa , ben rregjistrimin e pasurise se paluajtshme te dhuruar. Ne castin e regjistrimit, dhuruesi paguan pjesen,qe i takon agjentit te taksave.
    3. Ne rastet kur pranohet nga vete palet ose kur vertetohet ligjerisht simulim i dhurimit per llogari te nje shitjeje, per shmangie nga taksa, zbatohen taksa sa dyfishi i vleres,pavarsisht nga pergjegjesite e tjera sipas ligjeve ne fuqi.

## II-C TË ARDHURA NGA TATIMI MBI TË ARDHURAT PERSONALE

Tatimi mbi të ardhurat personale, llogaritet mbi të ardhurat e individëve. Njësitë e vetëqeverisjes vendore përfitojnë si taksë të ndarë, 2 (dy) për qind e të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale.

# KAPITULLI III

# TARIFAT VENDORE

**Llojet e tarifave subjekt i ketij vendimi jane :**

1. ***Tarifa Pastrimi***
2. ***Tarifa Ndricimi***
3. ***Tarifa Gjelberimi***
4. ***Tarifa Parkimi dhe pajisje me leje transporti***
5. Tarifa ne sektorin e ndertimit dhe zhvillimit te teritorit
6. Tarifa per dhenien e licencave (autorizimeve ) ne tregtim te karburanteve
7. Tarifa per zenien e hapsires publike
8. Tarifa per sherbime administrative

Ne baze te nenit 35 te ligjit 9632 dt. 30.10.2006 Bashkia krijon te ardhura nga tarifat vendore per:

- ✓ Sherbime publike qe ato afrojne (pastrim, gjelberim, ndricim, etj.)
- ✓ Te drejten e perdorimit te pronave publike vendore (psh, tarife parkimi,tarifa perdorimi te sheshеve vendore etj.)
- ✓ Dhenia e licencave, lejeve, autorizimeve, leshimi i dokumentave etj.

Ne pergjithesi tarifat e sherbimeve percaktohen me synimin mbulimin e kostove te tyre.
Me vendosjen e tarifave nga Bashkia kemi ne konsiderate vendosjen ne lidhje te drejperdrejte

midis tarifes dhe qellimit te perdorimit te saj, me synimin qe qytetaret te ndergjegjesohen dhe te ndjejne efektin e pageses se bere prej tyre.

Percaktimi i tarifes do te shoqerohet me publikim dhe njoftim qe personat, familjaret apo subjektet te njihen ne kohen e duhur.

Tarifat për pastrim, gjelbërim dhe ndriçim janë detyrime vjetore të tatimpaguesit ekzistues dhe për ata që regjistrohen rishtaz për periudhën e mbetur deri në fund të vitit ushtrimor. Për vendosjen e tarifave vendore (pastrim,ndriçim,gjelbërim) do të bëhet vlerësimi nga zyra,qe bazohet në dokumentacionin dhe informacionin që disponon,duke pasur parasysh faktet dhe rrethanat konkrete të biznesit,situatë ne tatimpaguesve të tjerë të ngjashëm, me synim rikarakterizimin e transaksioneve dhe llogaritjen sa më të saktë të detyrimeve tatimore në përputhje me legjislacionin tatimor në fuqi.

Taksapaguesit biznesi vogël apo i madh janë të detyruar të paguajnë tarifat dhe taksat vendore mbi biznesin për çdo vendndodhje biznesi, nëpërputhje me nivelin e tarifave dhe taksavevendore të përcaktuar për lloji te biznesit sipas vendimit të Këshillit të Bashkisë.

Bizneset nën administrimin e të njëjtit taksapagues që ushtrohen në një vendndodhje (në një godinë) do të tatohen gjithnjë si vendndodhje biznesi më vete.

Një"vendndodhjebiznesi"është një zonë e dallueshme dhe e ndarë si në të njëjtën godinë, ashtu edhe në godina të ndryshme. Per shembull :

*a)Kur veprimtari të ndryshme ekonomike kryhen nga një taksapagues në të njëjtën dhomë,konsiderohen si një vendndodhje e nje biznesi.*

*b)E njëjta veprimtari ekonomike e kryer nga një taksapagues në dy dhoma,që kanë komunikim nga brenda,konsiderohen një biznes,pra konsiderohen si një"vendndodhje biznesi"*

*c)Dy veprimtari të ndryshme ekonomike të kryera nga një taksapagues në dy dhoma,që kanë komunikim nga brenda,konsiderohen dy biznese,pra konsiderohen si dy "vendndodhje biznesi".*

## 1. TARIFA PASTRIMI

***Tarifa e pastrimit dhe largimit te mbetjeve per Biznesin e Madh dhe te Vogel***

| NR | LLOJI I BIZNESIT | NJESIA | Biznes i Vogel | Biznes i Madh |
|---|---|---|---|---|
| | **Per cdo subjekt ne bashkine Prrenjas dhe Njesite Administrative** | **Lekë/vit/njësi** | **Tarifa e Percaktuar** | **Tarifa e Percaktuar** |
| 1 | Parukeri ,Berberane,Estetik,butik | Lekë/vit/njësi | 7,000 | 20,000 |
| 2 | Restorant, Taverne,Rosticeri,Bujtine, Hotel, Motel | Lekë/vit/njësi | 10,000 | 80,000 |
| 3 | Bar Kafe, Furre buke,piceri,byrektore,pasticeri, bilardo etj, te ngjashme me to. | Lekë/vit/njësi | 6,500 | 35,000 |
| 4 | Sherbime funerale,sherbime optike , kabllor,+ internet ,kancelari ,tregtim lulesh,kembim valutor,agjensi sherbimesh,siguracionesh , agjensi trensfertash,aktivitete informatike, etj tengjashme me to | Lekë/vit/njësi | 9,000 | 50,000 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 5 | Lavazhe,bazene peshku, auto shkolle, tregtim pjese kembimi, tregtim artikuj mobilerie, fotograf, kembim valutor, palester , etj te ngjashme me to. | Lekë/vit/njësi | 7,000 | 50,000 |
| 6 | **PROFESIONE TE LIRA**<br>Profesione te Lira (Avokat,noter,arkitekt, inxhinier,topograf ,projektues, ekonomist,agronom,ekspert kontabel I rregjistruar,kurse kualifikimi, kontabilist,ndryshuar sipas ligjit dhe vlersues I miratuar I pasurise). | Lekë/vit/njësi | 8,000 | 50,000 |
| 7 | Farmaci, Farmaci, Klinike Dentare,laborator,bime medicinale,mjek i specializuar, dentist, dentist i specializuar, farmacist,fizioterapist, infermier,farmaci veterinare,/bime medicinale,mjek-laborant,bujqesore/ veterinare | Lekë/vit/njësi | **9,000** | **50,000** |
| 8 | Materiale ndertimi,Perpunim hekuri,alumini,Perpunim druri,mermeri,Riparime auto,Riparime elektrike,Servis auto,Tornitor,Riparime argjendarie | Lekë/vit/njësi | 10,000 | 65,000 |
| 9 | AMBULANT Subjekte qe nuk kane nje vendndodhje fikse , tregtia ambulante | Lekë/vit/njësi | 6,000 | - |
| 10a) | **Njesi per tregtim karburanti**<br>Karburante ne Rruge Nacionale | Lekë/vit/njësi | - | 110,000 |
| 10b) | Karburante ne rruge Nacionale (me zone kadastrale Njesi Administrative ) | Lekë/vit/njësi | - | 85,000 |
| 10c) | Karburante ne rruge Rurale | Lekë/vit/njësi | 12,000 | 50,000 |
| 11 | Banka te nivelit te dyte,Fondacione , Institucione ,ujesjellsa,Spitali, Sigurime shoqerore,Posta Shqiptare | Lekë/vit/njësi | - | 80,000 |
| 12 | Taksi 4+1, 8+1, Transport udhetaresh mbi 8+1 | Lekë/vit/njësi | 5,000 | 45,000 |
| 13 | Fruta Perime ,Dyqan Mishi | Lekë/vit/njësi | 8,000 | - |
| 14 | Supermarkete ,Markete, shitje me shumice te artikujve ushqimore dhe industriale | Lekë/vit/njësi | 10,000 | 90,000 |
| 15 | Lende Drusore , Transporte te lendeve drusore | Lekë/vit/njësi | 10,000 | 100,000 |
| 16 | Hec, Tec,Gurore,Minierat +Nyje betoni | Lekë/vit/njësi | - | 110,000 |
| 17 | Fabrike perpunimi,Prodhimi , | Lekë/vit/njësi | - | 90,000 |
| 18 | Ngritje Kompleksi ,fasoneri . | Lekë/vit/njësi | - | 100,000 |
| 19 | Per te gjitha subjektet qe zhvillojne aktivitet ne territor te bashkise Prrenjas nga tenderat,per ndertim apo rikonstruksion rruge rruge,shkolla ujesjellsa etj ,jo rezident ne bashkine Prrenjas | Lekë/vit/njësi | - | 60,000 |
| 20 | Per te gjitha subjektet me Nipt sekondar dhe per subjekte B.M te pacituar me lart | Lekë/vit/njësi | - | 50,000 |

Tarifa e pastrimit dhe largimit te mbeturinave për familjet

| FAMILJARET ( Per Fryme ) | Leke/vit/fryme |
|---|---|
| Njësia Administrative PRRENJAS | 500 |
| Njësitë e tjera Administrative Rrajce,Qukes, Stravaj | 500 |

- **Përkufizimi**:"Tarifë e pastrimit dhe largimit të mbeturinave" është një pagesë, që bëhet drejtpërdrejt apo nëpërmjet një nëpunësi tek administrata tatimore vendore në shkëmbim të shërbimit të marrë, për çdo anëtarë (frymë) në familje, person fizik apo juridik, vendas ose të huaj, që banojnë/janë rezidentë dhe ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë Prrenjas dhe njësive të saj administrative.
- **Per vitin 2023** sherbimi i pastrimit do te shtrihet ne te gjithe territorin e bashkise Prrenjas , duke perfshire edhe Njesite Administrative te cilat nuk kane qene te perfshira vitet e mepareshme por vetem disa nga fshatrat,kurse kete vit sherbimi i pastrimit do te shtrihet ne te gjithe territorin e njesive administrative.
- Gjithashtu per vitin 2023 bashkia do te asfaltoje rruget e fshatrave , Rashtan ,Kotodesh ,Skroske dhe ne kete menyre do te shtohet sherbimi i pastrimit ne te gjithe segmentet e asfaltuara .
- **Baze e tarifes:** Numri i anëtarëve të një familje, numri bizneseve dhe numri i institucioneve ne Njesite Administrative të Bashkise Prrenjas qe ju ofrohet ky sherbim.
- **Niveli i tarifës së pastrimit:** Kategoritë, nënkategoritë dhe nivelet treguese janë të shprehura si më poshtë:
- **Struktura e ngarkuar për mbledhjen** e kësaj takse është Drejtoria e te Ardhurave dhe Licensave Bashkia Prrenjas. Pagesa kryhet pranë arkës së bashkise/Nj.Administrative dhe në çdo bankë te nivelit të dytë dhe prane sportele te postes shqiptare ).Tarifat per familjaret do te aplikohet vetem aty ku merret ky sherbim.(Ne rastet kur kostatohet se nuk ka sherbim atehere familjeret nuk do ta paguajne kete tarife, kostatime do te behet nga specialisti perkates i cili merret me sherbimin e pastrimit.)
- ***Policia Bashkiake mbeshtet ispektoret e Tatim-Taksave*** per vjeljen me force te detyrimit tatimor kur detyrimi nuk eshte paguar ne afat.
- **Afati i pagesës** së detyrimit do te behen per familjaret me nje kest deri ne **datën 31.12.2023** brenda vitit kalendarik, per subjektet mundet te paguhen vetem me nje kest ku afati i fundit eshte data **30.09.2023 ku te jene likujduar te gjitha detyrimet.**
- **Sanksione**: Për mospagesë në afatin e caktuar per kategorine biznese/institucione do të zbatohen procedurat për marrjen e masave të detyrimit tatimor sipas ligjit nr 9920, date 19,05.2008, "Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperisë" dhe do të aplikohet gjobë në masën 1.8% çdo muaj vonesë, por jo më shumë se 12 muaj.
- **Afati i njoftimit** të tatimpaguesit do të jetë deri në datën 30.04.2023.

- **Perjashtohen**: Perjashtohen nga tarifa e pastrimit, personat me aftesi te kufizuar, te vertetuar me vendim te Komisionit Mjekesor te Caktimit te Aftesise per Pune (KMCAP),te cilet duhet te paraqesin dokumentacionin perkates ,prane Drejtorise se te Ardhurave.
- Për subjektet e reja detyrimi tatimor do të llogaritet për çdo njësi ku subjekti kryen aktivitet nga muaji korrent i regjistrimit pranë QKB.
- **Për të gjitha kategoritë:** Nëse subjekti taksapagues pushon veprimtarinë gjatë vitit, detyrimi tatimor llogaritet duke shumëzuar tarifën për vitin e plotë kalendarik me numrin e muajve të plotë gjatë të cilëve veprimtaria është kryer (përfshirë muajin korrent për të cilin është bërë kërkesa) dhe duke e pjesëtuar atë me 12 muajt e vitit kalendarik fiskal.

## 2. TARIFA NDRIÇIMI

- **Përkufizimi**: Tarifa e ndriçimi është një pagesë, që bëhet drejtpërdrejt apo nëpërmjet një nëpunësi tek administrata tatimore vendore në shkëmbim të shërbimit të marrë, për çdo anëtarë (frymë) në familje, person fizik apo juridik, vendas ose të huaj, që banojnë/janë rezidentë dhe ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë Prrenjas dhe njësive të saj administrative.
- **Baze e tarifes:** Numri i anëtarëve të një familje, numri bizneseve dhe numri i institucioneve ne Njesite Administrative të Bashkise Prrenjas qe ju ofrohet ky sherbim.
- **Niveli i tarifes**: Kategoritë, nënkategoritë dhe nivelet treguese të Tarifës së ndricimit janë si më poshtë:

| Kodi | GRUPIMI I TATIMPAGUESVE | Tarife NDRICIMI leke/viti |
|---|---|---|
| A | Per familjaret qyteti Prrenjas edhe per Njesite Administrative aty ku jepet sherbimi | 200/lek/fryme/vit |
| B | Për te gjitha subjektet Biznes i Madh institucionet ne territorin e Bashkise Prrenjas | 10,000 lek /vit |
| C | Per te gjithe subjektet Biznes i vogel (Qytet Prrenjas) | 5,000 |
| D | Transport udhetaresh 8+1 | 4,000 |
| E | Transport udhetaresh 4+1 | 3,000 |

- **Struktura e ngarkuar për mbledhjen** e kësaj takse është Drejtoria e te Ardhurave dhe Licensave Bashkia Prrenjas. Pagesa kryhet pranë arkës së bashkise/Nj.Administrative dhe në çdo bankë te nivelit të dytë).Tarifat per familjaret apo subjekte do te aplikohet vetem aty ku merret ky sherbim. ***Policia Bashkiake mbeshtet ispektoret/specialistet e Tatim-Taksave*** per vjeljen me force te detyrimit tatimor kur detyrimi nuk eshte paguar ne afat.
- **Afati i pagesës** së detyrimit do te behen per familjaret me nje kest deri ne data **31.12.2023** brenda vitit kalendarik, per subjektet mundet te paguhen vetem me nje kest ku afati i fundit eshte data **30.09.2023 ku te jene likujduar te gjitha detyrimet.**
- **Sanksione**: Për mospagesë në afatin e caktuar per kategorine biznese/institucione do të zbatohen procedurat për marrjen e masave të detyrimit tatimor sipas ligjit nr 9920, date

19.05.2008, "Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperisë" dhe do të aplikohet gjobë në masën 1.8% çdo muaj vonesë, por jo më shumë se 12 muaj.

- **Afati i njoftimit** të tatimpaguesit do të jetë deri në datën **30.04.2023.**
- **Perjashtohen**: Perjashtohen nga tarifate ndricimit, personat me aftesi te kufizuar, te vertetuar me vendim te Komisionit Mjekesor te Caktimit te Aftesise per Pune(KMCAP),te cilet duhet te paraqesin dokumentacionin perkates ,prane Drejtorise se te Ardhurave dhe Licensave.

## 3. TARIFA GJELBERIMI

- **Përkufizimi**: Tarifa e gjelberimit është një pagesë, që bëhet drejtpërdrejt apo nëpërmjet një nëpunësi tek administrata tatimore vendore në shkëmbim të shërbimit të marrë, për çdo familje, person fizik apo juridik, vendas ose të huaj, që banojnë/janë rezidentë dhe ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë Prrenjas dhe njësive të saj administrative.
- **Baze e tarifes:** Numri i familjeve, numri bizneseve dhe numri i institucioneve ne Njesite Administrative të Bashkise Prrenjas qe ju ofrohet ky sherbim.
- **Niveli i tarifes**: Kategoritë, nënkategoritë dhe nivelet treguese të Tarifës së gjelberimit janë si më poshtë:

Tarife Gjelberimi

| Kodi | GRUPIMI I TATIMPAGUESVE | Tarife GJELBERIMI leke/viti |
|---|---|---|
| A | Per familjaret Tarife | 250 / leke/familje/vit |
| B | **BIZNESI MADH** | |
| 1 | Regjistruar ne regjistrin e tatimpaguesve te medhenj (VIP) | 7,000 |
| 2 | Per te gjitha subjektet B.Madh + nipt sekondar +Sigurimet shoqerore, ujsjellsi, pika karburanti | 6,000 |
| | **BIZNES I VOGEL** | |
| 1 | Per subjektet Biznes i vogel :<br>Bar – Restorante, Hotele, Motele per Qytetin Prrenjas , | 4,000 |
| 2 | Per te gjitha subjektet **B.Vogel Qytet Prrenjas** | 2,000 |
| 3 | Per Subjektet ne Njesite Administrative B.Vogel nuk ka Tarife Gjelberimi. | Nuk ka Tarife |

- **Struktura e ngarkuar për mbledhjen** e kësaj takse është Zyra e Tatim-Taksave Bashkia Prrenjas.Pagesa kryhet pranë arkës së bashkis/Nj.Administrative dhe në çdo bankë te nivelit të dytë).Tarifat per familjaret apo subjekte do te aplikohet vetem aty ku merret ky sherbim.
  Policia Bashkiake mbeshtet ispektoret e Tatim-Taksave per vjeljen me force te detyrimit tatimor kur detyrimi nuk eshte paguar ne afat.
- **Afati i pagesës** së detyrimit do te behen per familjaret me nje kest deri **datën 31.12.2023** brenda vitit kalendarik, per subjekte mundet te paguhen vetem me nje kest ku afati i fundit eshte data **30.09.2023 ku te jene likujduar te gjitha detyrimet.**
- **Sanksione**: Për mospagesë në afatin e caktuar per kategorine biznese/institucione do të zbatohen procedurat për marrjen e masave të detyrimit tatimor sipas ligjit nr 9920, date

19,05.2008, "Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperisë" dhe do të aplikohet gjobë në masën 1.8% çdo muaj vonesë, por jo më shumë se 12 muaj.

- **Afati i njoftimit** të tatimpaguesit do të jetë deri në datën 30.04.2023.

## 4. TARIFA PARKIMI DHE PAJISJE ME LEJE TRANSPORTI

- **Baza e tarifes**: Jane subjektete dhe pronaret e automjeteve te transportit qe sigurojne parking te rezervuar ne hapesirat publike ne territorin e Njesise Administrative Prrenjas.
- **Niveli i Tarifes:** Eshte ndare ne 4-kategoritë dhe nivelet treguese të Tarifës së parkimit per secilen kategori janë si më poshtë:

| TARIFË PARKIMI | LEKE /VIT |
|---|---|
| ( Qyteti Prrenjas ) | |
| 1. autoveturataksi 8 + 1 vende | 1. 5 000 lekë/ viti |
| 2. autoveturataksi 4 + 1vende | 2. 3 000 lekë/ viti |
| 3. automjet transport malli deri 3,5 T (mengarkesë) | 3. 1 500 lekë/ viti |
| 4. automjet transport malli mbi 3,5 T (mengarkesë) | 4. 2 000 lekë/ viti |
| **Tarifë parkimi automjete** | |
| 5. Parkim me pagesë (në sheshe dhe zona të miratuara) | 5. 50 leke/ore/mjet |

- **Struktura pergjegjese** per dhenien e Lejeve per hyrje ne qytet per transport mallrash eshte Drejtoria e te Ardhurave dhe Licensave.
- **Struktura pergjegjese per kontrollin** dhe penalitet eshte Policia Bashkiake Prrenjas .

## 5. TARIFA NE SEKTORIN E NDERTIMIT DHE ZHVILLIMIT TE TERITORIT

- **Baza e Tarifes** jane numri i çertifikatave dhe dëshmive qe jep Sektori i Ndertimit per investitoret ndertues kundrejte sherbimeve si me poshte vijon me vlerat perkatese:

a) Dhënie çertifikate pastërtie për firmat e ndërtimit (leje ndërtimi dhe leje shfrytëzimi) **1,000 lekë**
b) Dhënie deshmi penaliteti per firmat e ndertimit **1,000 lekë**

Të gjitha subjektet ndërtuese do të tërheqin lejen e ndërtimit pranë Bashkise Prrenjas vetëm pasi të kenë paguar para zbardhjes së lejes së ndërtimit detyrimet përkatese për selinë administrative,detyrimet për"çdokantierndërtimi" si dhe pasi të kenë paguar taksën e ndikimit në infrastrukturë.

- **Struktura e ngarkuar** për dhënie leje ndërtimi, përllogaritjenevlerëssë taksave dhe tarifave,vjeljen e tyre dhe penalitetet është Drejtoria e Planifikimit Zhvillimit te Territorit Aseteve dhe Mbrojtes Civile pranë Bashkisë Prrenjas.
- **Menyra e pageses llogaritet** nga Drejtoria e Planifikimit Zhvillimit te Territorit Aseteve dhe Mbrojtjes Civive dhe me pas pagesa behet ne arken e Bashkise Prrenjas

## 6. TARIFA PER DHENIEN E LICENCAVE (AUTORIZIMEVE ) NE TREGTIM TE KARBURANTEVE

LIÇENCA/ AUTORIZIME

Dhënie E Liçencave Për Tregëtimin E Naftës Bruto Dhe Nën Produkteve Të Saj

Bazuar Në Ligjin Nr.8450, Datë 24.2.1999 "Për Përpunimin, Transportimin Dhe Tregëtimin E Naftës, Të Gazit Dhe Nënprodukteve Të Tyre" Të Ndryshuar Me Ligjin Nr .9218, Datë 08.04.2004 "Për Disa Shtesa Dhe Ndryshime Në Ligjin Nr.8450, Datë 24.2.1999 "Për Përpunimin, Transportimin Dhe Tregëtimin E Naftës, Gazit Dhe Nënprodukteve Të Tyre", Si Dhe Në Vendimin E Këshillit Të Ministrave Nr. 129, Datë 18.03.1999 "Për Proçedurat Dhe 20 Kushtet Për Dhënien E Lejeve E Të Autorizimeve Për Tregëtimin E Naftës, Të Gazit E Të Nënprodukteve Të Tyre" Të Ndryshuar Me Vendimet E Këshillit Të Ministrave Nr. 170, Datë 25.04.2002 & Nr. 563, Datë 27.08.2004 "Për Disa Shtesa Dhe Ndryshime Për Proçedurat Dhe Kushtet Për Dhënien E Lejeve E Të Autorizimeve Për Tregëtimin E Naftës, Të Gazit E Të Nënprodukteve Të Tyre",Vkm Nr. 970, Datë 02.12.2015 Për "Përcaktimin E Procedurave Dhe Të Kushteve Për Dhënien E Liçencave Për Tregëtimin E Naftës Bruto Dhe Nën Produkteve Të Saj"

Bashkia Prrenjas ,jep liçence për personat juridikë të cilët ushtrojnë veprimtarinë e tyre për tregëtimin e karburanteve për automjete (stacionet e shitjes së karburanteve) dhe për shitjen e lëndëve djegëse (njësitë e shitjes së lëndëve djegëse) në territorin e Bashkisë Prrenjas.

Autorizimet jepen nga Bashkia Prrenjas **për një periudhë deri në 5 (pesë) vjet** me të drejtë përsëritjeje dhe pagesa për dhënie autorizimi për dy kategoritë e mësipërme është si më poshtë vijon.

- Pagesë për dhënien dhe përsëritjen e liçencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjete dhe vajra lubrifikante. 1,000,000 lekë
- Pagesë për dhënien dhe përsëritjen e liçencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregëtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë. 100,000 lekë .

Shënim: Për dublikatë për të njëjtin stacion dhe afat vlefshmërie apo rastet e ndryshimeve në liçencë që kanë të bëjnë me elementet e përdoruesit të stacionit paguhet 20% e vlerës së plotë.
Struktura e ngarkuar për dhënien e kësaj liçence dhe vjeljen e detyrimit është Drejtoria e Kontrollit Territorit në Bashkinë Prrenjas .
Struktura e ngarkuar për penalitetet për mos pajisje dhe mos zbatim të saj (bazuar në rregulloret përkatëse) është Drejtoria e Kontrollit te Territorit në Bashkinë Prrenjas.

## 7. TARIFA PER ZENIEN E HAPSIRES PUBLIKE

- **Perkufizim:** Hapesire publike eshte hapesira e jashtme si rruga, trotuari, sheshi, lulishtja, parku e te tjera te ngjashme ne sherbim te komunitetit, ku menaxhimi mund te jete publik/dhe ose privat.
- Hapesira publike perfshin rruge, kalime publike dhe mjedise qe jane te hapura per publikun, ose ne sherbim te perdorimit publik. Zënia e hapësirës publike për qëllime biznesi konsiderohet vendosje mallrash jashtë vendit të tregtimit, vendosje tavolinash, sipërfaqet e zëna me platforma, sipërfaqe të rrethuara me vazo me lule, bime dekorative, me kangjella,

drurë dekorative, etj.

- **Baza e taksës** për zënie të hapsirave publike është sipërfaqja në $m^2$, e cila vihet në shfrytëzim nga subjekte për qëllime biznesi.
